

## Titulli i temës së Masterit:

*“Veçoritë tipike të procedurës së veçantë civile me konstatim të vlerës së vogël”*

**Kandidati:** Lindon Azemi

**Mentori:** Prof.Dr. Iset Morina LL.M.

### Abstrakti:

Kontestet me vlerë të vogël, zënë vend shumë të rëndësishëm në kuadër të procedurave të posaçme kontestimore, ato parashihen me normat e nenit 484 deri në 491 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Republikës së Kosovës. Në kuptim të kësaj me konteste të vlerës së vogël nënkuptojmë të gjitha ato kërkesa juridike-pasurore respektivisht të gjitha ato konteste në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesë në të holla, shuma e të cilave nuk është më e madhe se 500 Euro. Sipas LPK-së konteste të vlerës së vogël, konsiderohen edhe kontestet në të cilat kërkesëpadia nuk ka të bëjë në të holla, por në të cilat paditësi në padinë e tij ka theksuar se pranon që në vend të përmbushjes jo në të holla, t’i paguhet shuma e të hollave që nuk është më e madhe se 500 Euro. Po që se pala paditëse e ndryshon kërkesëpadinë me anë të zmadhimit të saj duke kapërcyer kështu kufirin prej 500 Euro, procedura e filluar do të vazhdohet dhe përfundohet sipas dispozitave për procedurën të përgjithshme kontestimore, si dhe anasjelltas. Në kuptimin e ligjit për procedurë kontestimore, konteste të vlerës së vogël nuk konsiderohen, kontestet lidhur me sendet e paluajtshme, kontestet sipas padisë për pengim posedimi si dhe kontestet nga marrëdhënia e punës, pa marrë parasysh se sa është e treguar vlera e objektit të kontestit në padi. Veçori tjetër e kësaj procedure të posaçme kontestimore, qendron edhe tek procedura sipas mjetit të goditjes respektivisht Ankesës si mjet i rregullt juridik me anë të së cilës sfidohet vendimi i gjykatës së shkallës së parë, vendim i formës jo i prerë. Shkaqet për paraqitje të mjetit të rregullt juridik (Ankesa) dallojnë prej procedurës së përgjithshme kontestimore në faktin, se në këto konteste nuk vlejne disa rregulla që vlejne në procedurë të përgjithshme. Dallimi qendron te Afati për paraqitje të Ankesës I cili është 7 ditë,

dhe se Ankesa paraqitet vetem për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të Ligjit për procedurën Kontestimore, si dhe zbatim të gabuar apo aplikim të gabuar të së drejtës materiale, dhe jo për konstatim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike. ndërsa procedura sipas mjetit të jashtëzakonshëm të goditjes së vendimit të gjykatës së shkallës së dytë të vendimit i formës së prerë, Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në kuptim të nenit 211 paragrafi 3 i LPK-së për faktin e vlerës së objektit të kontestit.

**fjalët kyqe:** Kontest, vlerë e vogël, vendim, Ankesa etj,...